



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1214/g Prot.

Tiranë, më 18.06.2026

VENDIM

Nr. 21, Datë 18.06.2026

PËR  
MIRATIMIN E LISTËS SË 38 PROJEKTEVE TË KUALIFIKUARA DHE  
VLERËSIMEVE ME PIKË,  
TË THIRRJES PËR PROJEKT-PROPOZIME TË PËRBASHKËTA NË FUSHAT E  
KËRKIMIT SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK SHQIPËRI – TURQI 2026–2028

Në zbatim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 109/2024 “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM nr. 464, datë 31.07.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), Bazuar në “Protokollin për Bashkëpunimin në Shkencë dhe Teknologji ndërmjet Këshillit të Kërkimeve Shkencore dhe Teknologjike të Turqisë (TÜBİTAK) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë”, datë 06.04.2010, me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Bordi i Administrimit të AKKSHI në mbledhjen e datës 18.06.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së 38 projekteve të kualifikuara dhe vlerësimeve me pikë në kuadër të thirrjes për projekt-propozime të përbashkëta në fushat e kërkimit shkencor dhe teknologjik Shqipëri – Turqi 2026–2028, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet AKKSHI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Znj. Armela Baka, Kryetar; \_\_\_\_\_  
Z. Vasil Tole, Anëtar; \_\_\_\_\_  
Z. Erjon Uka, Anëtar; \_\_\_\_\_  
Znj. Mirela Cami, Anëtar; \_\_\_\_\_

Znj. Juljana Margariti, Anëtar; \_\_\_\_\_  
Znj. Anisa Subashi, Anëtar; \_\_\_\_\_  
Z. Fatbardh Sallaku, Anëtar; \_\_\_\_\_  
Z. Migel Hidi, Anëtar; \_\_\_\_\_